

Në bazë të nenit 5 dhe nenit 21 të rregullorës së punës së Këshillit Drejtues thërras mbledhjen e shtatë me radhë të Këshillit të Përkohshëm Drejtues të Akademisë dhe propozoj këtë:

REND DITE

1. Konstituimi i Këshillit Drejtues;
 - Verifikimi I mandateve të anëtarëve të Këshillit Drejtues;
2. Zgjedhja e kryetarit
3. Zgjedhja e zëvendës kryetarit të KD
4. Të tjera.

Mbledhja do të mbahet në Akademi në sallën e takimeve më 04.03.2022 (e premte) në ora 10:00.

Anëtari më i vjetër i Këshillit të Përkohshëm Drejtues

Muharrem Salihu

E K S T R A K T

Nga mbledhja e shtatë e Këshillit të Përkohshëm Drejtues të mbajtur me datë 04.03.2022, në Akademi duke filluar prej orës 10.00.

Prezentë:

1. Dr.Sc. Ema Berisha Krasniqi –anëtare nga Këshilli Akademik.
2. Muharrem Salihu-anëtari më i vjetër i Këshillit të Përkohshëm Drejtues
3. MSc.Sara Fusha Osmani-anëtare nga Këshilli Akademik
4. MSc. Lutfi Gashi – anëtar nga shoqëria civile
5. MSc. Sami Mazreku – anëtar Këshilli i Partënerëve
6. Arsim Zagragja-anëtar nga Parlamenti Studentor i Akademisë
7. Dr.Sc.Muhamed Krasniqi Drejtor i Akademisë – anëtar pa të drejtë vote;
8. Fatime Krasniqi Sekretare e Përgjithshme e Akademisë - anëtar pa të drejtë vote

Mbledhjen e hapi anëtari më i vjetër i Këshillit të Përkohshëm Drejtues, i cili i falënderoj për prezencën anëtarët dhe propozoi për miratim këtë:

REND DITE

1. Konstituimi i Këshillit Drejtues;
5. Verifikimi i mandateve të anëtarëve të Këshillit Drejtues;
2. Zgjedhja e kryetarit
3. Zgjedhja e zëvendës kryetarit të KD
4. Të tjera.

Rendi i ditës i propozuar u miratua unanimisht nga të gjithë anëtarët.

I. Konstituimi i Këshillit Drejtues

Anëtari z. Muharrem Salihu, hapi diskutimin në lidhje me plotësimin dhe zgjedhjen e përhershme të anëtarëve të Këshillit Drejtues. Sekretarja e Akademisë, znj. Fatime Krasniqi kërkoj fjalën dhe paraqiti para anëtarëve vendimin për delegim të dy anëtarëve nga Këshilli Akademik sipas Statutit të Akademisë. Anëtarët e deleguar janë Dr.sc. Ema Krasniqi dhe Msc. Sara Fusha Osmani. Gjithashtu, znj. Krasniqi paraqiti anëtarin Arsim Zagragja për anëtar të Këshillit të cilin e ka deleguar Parlamenti Studentor i Akademisë. Më pas fjalën e mori drejtori i Akademisë Dr.sc. Muhamed Krasniqi, i cili duke u bazuar në Statutin e Akademisë paraqiti dy anëtarët për Këshill Drejtues. Msc. Sami Mazreku u propozua si anëtar nga këshilli i partneritetit si dhe Msc. Lutfi Gashi si anëtar nga shoqëria civile.

Anëtari më i vjetër mori fjalën dhe uroj anëtarëve të Këshillit Drejtues punë të mbarë.

II. Zgjedhja e kryetarit të Këshillit Drejtues

Z. Salihu, vazhdoi me pikën e dytë të rendit të ditës për zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të Këshillit Drejtues.

Znj. Osmani mori fjalën dhe propozoi Dr.sc. Ema Berisha-Krasniqi për kryetare të Këshillit Drejtues. Meqenëse nuk pati propozime tjera atëhere u hodhë në votim. Votimi u vendos të bëhet i hapur (aklamacion) sepse nuk kishte propozime tjera. Anëtarët në mënyrë unanime miratuan këtë propozim dhe u vendos që zgjedhja e Kryetar të Këshillit Drejtues të bëhet me votim të hapur (me akklamacion).

Propozimi për Kryetar të Këshillit Drejtues u hodh në votim dhe anëtarët e Këshillit me vota unanime zgjodhën Dr.Sc. Ema Berisha-Krasniqi Kryetare të Këshillit Drejtues, e cila nga ky moment mori kryesimin e mbledhjes së Këshillit. Mandati i Kryetares së Këshillit të Drejtues, vlenë deri në organizimin e zgjedhjeve të rregullta në Akademi.

III. Zgjedhja e Zëvendës Kryetarit të Përkoshëm Këshillit Drejtues

Mbledhjan e vazhdoi Kryetarja e Këshillit Drejtues Znj. Berisha, e cili kërkoj nga të pranishmit të propozojnë kandidatë për Zëvendës Kryetar të Këshillit Drejtues.

Lutfi Gashi për Zëvendës Kryetarit të Këshillit Drejtues propozon MSc. Sara Fusha Osmani. Tjera propozime nuk pati dhe ky propozim u hodh në votim.


Meqenëse kishte propozim vetëm për një kandidat, u veprua njëjtë sikur në zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Drejtues përmes votim të hapur (aklamacion).

Propozimi për Zëvendës Kryetar të Këshillit Drejtues u hodh në votim dhe anëtarët e Këshillit me vota unanime zgjodhën MSc. Sara Fusha Osmani, Zëvendës Kryetare e Këshillit Drejtues.

Të tjera nuk pati në këtë takim.

Mbledhja përfundoi në ora 11:00.

Kryetarja e Këshillit Drejtues
Dr.Sc. Ema Berisha Krasniqi



Procesmbajtëse:
Zj. Makfire Preniqi
